



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 544/5 Prot.

Tiranë, më 30/07/2018

V E N D I M

Nr. 94, Datë 30/07/2018

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR
NË INSTITUTIN E SHËNDETIT PUBLIK, MBI "AUDITIMIN E PASQYRAVE
FINANCIARE".**

Nga auditimi i ushtruar në Institutin e Shëndetit Publik, me objekt "*Auditimin e pasqyrave financiare*", për periudhën 01.01.2016 deri në 31.12.2017, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë jo materiale për të cilën japim opinion të pakualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Mbi auditimin e pasqyrave financiare*", të ushtruar në Institutin e Shëndetit Publik, Tiranë sipas programit të auditimit nr. 544/1, dt. 07.05.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion i pakualifikuar (me rezervë):

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Institutit të Shëndetit Publik për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve*) (*pagesave*) në para, pasqyrën e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standartet ISSAI 1700¹, dhe ISSAI 1200², me përjashtim të efekteve të çështjeve të trajtuara në opinionin me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Institutit të Shëndetit Publik në datën 31 dhjetor 2017.

E gjykojmë të arsyeshme të konstatojmë, se ka probleme për çështje specifike për të cilat duhet të japim një paragraf shpjegues mbi rezervat që kemi.

Opinionin me rezervë:

Në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se menaxhimi i subjektit, mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare nëse atij nuk do t'i vihen në dukje rezervat që kemi për çështje specifike të pazakonta të konstatuara:

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj *për rezervat në opinion* te fakti se nuk jemi dakord për disa çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave si:

- Konstatohet se në pasqyrat financiare të ISHP për vitet 2016 dhe 2017, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve si dhe vlera e tyre prej 583,138,710 lekë, nuk rezultojnë të regjistruara në AQT, (*janë evidentuar për vleftën zero lekë*).

- Konstatohet se, për tre zëra të paraqitura në nën llogarinë “*Ndërtesa e konstruksione*”, si “*Godina e Klubit*” në vlerën 7,500 lekë, “*Godina e Garazheve*” në vlerën 20,500 lekë dhe “*Qendra e Trajnimeve*” në vlerën 347,000 lekë, vlerësimet në AQT janë jo realiste, me vlera simbolike dhe të paargumentuara, duke mos pasqyruar vlerën reale të aktiveve.

- Në pasqyrat financiare të vitit 2017 në llog. 520 “*Disponibilitete në thesar*” në aktiv të bilancit paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara për vlerën 12,930,761 lekë të kontabilizuara në kredi në llogaritë “*Rezultati i mbartur nga funksionimi*” dhe “*Rezultati ushtrimor nga funksionimi*” duke i denaturuar këto llogari kur vlera e mësipërme duhej të paraqitej në klasën 4 “*Detyrimet afat shkurtra*” që përfaqësohet nga shuma detyrimeve afatshkurtër. Në rastin konkret, si kundërparti duhet të shërbejë llogaria 476 “*Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur*”.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se në pasqyrat financiare të ISHP për vitet 2016 dhe 2017, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve si dhe vlera e tyre, nuk rezultojnë të regjistruara në AQT, (*janë evidentuar për vleftën zero lekë*). Sipërfaqja totale e tokës që ka ISHP në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Janë hartuar dokumentacionet, planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që ISHP ka në

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

dispozicion, plani i rilevimit (*kadastral dhe topografik*), plan vendosjet me rrjetin koordinativ dhe ortofoton përkatëse, planimetritë për secilin objekt dhe për çdo kat se si janë organizuar, si dhe formulari për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore. Bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (*Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 961*), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (*referuar çmimeve të vitit 2014*), për zonën kadastrale nr. 8120, përcaktohet me çmimin prej 29,106 lekë/m². Nga përllogaritjet për sipërfaqen të tokës truall prej 20,035 m² që administron ky institucion me çmimin për zonën kadastrale nr. 8120, në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016 rezulton vlera 583,138,710 lekë, e cila duhej pasqyruar në AQT (zëri “toka, troje e terrene”) të ISHP, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi dhe administrim të ISHP bëhet domosdoshmëri azhurnimi, rakordimi dhe pasqyrimi në kontabilitetin e Institutit të Shëndetit Publik i vlerave të këtyre pasurive bazuar në informacionin e administruar nga vlerësuesi i pavarur.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i të dhënave të evidencës analitike të ndërtesave rezulton se, në pasqyrat analitike që shoqërojnë bilancin kontabël të vitit 2016 dhe 2017, gjendja e nënllogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione”, përputhet me shumën e vendosur në llog. 212, në Aktiv të Bilancit Kontabël, e cila detajohet si vijon:

lekë

Ndërtime konstruksione	Viti 2016	Viti 2017
1.Godina qendër	35,006,040	35,006,040
2.Godina laborator mikrobik	31,996,293	31,996,293
3.Qendra e trajnimeve	347,000	347,000
4.Godina e magazinës	1,204,675	1,204,675
5.Godina e garazheve	20,500	20,500
6.Godina e klubit	7,500	7,500
7.Godina e vivariumit	725,000	725,000
8.Muri rrethues	968,199	968,199
Shuma	70,245,207	70,245,207

Burimi: Sektori i Financës, ISHP.

Nga auditimi konstatohet se, për tre zëra të paraqitura në nën llogarinë “Ndërtesa e konstruksione”, si “Godina e Klubit” në vlerën 7,500 lekë, “Godina e Garazheve” në vlerën 20,500 lekë dhe “Qendra e Trajnimeve” në vlerën 347,000 lekë, vlerësimet në AQT janë jo realiste, me vlera simbolike dhe të paargumentuara, duke mos pasqyruar vlerën reale të aktiveve, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Të merren masat nga ana e ISHP për kryerjen e procesit të rivlerësimit të ndërtesave, për zërat e paraqitur në nën llogarinë “Ndërtesa e konstruksione”, me ekspertë të fushës, për të siguruar një pasqyrim sa më real të vlerës së këtyre aktiveve. Mungesa e kryerjes së vlerësimeve dhe regjistrimit të pasurisë me vlerën e tyre të drejtë në kontabilitet shton rrezikun që informatat e prezantuara në regjistrin e pasurisë të mos përmbushin kërkesat e raportimit financiar. Për sa sipër, të ndërtohen kontrollet dhe procedurat e brendshme në përputhje me cilësimet e paragrafit 18, të Standardit Kombëtar Kontabël nr. 5, që nënvizojnë se, “Njësia ekonomike do të zgjedhë si politikë të saj kontabël modelin e kostos (i cili shpjegohet në paragrafin 19), ose modelin e rivlerësimit (i cili shpjegohet në paragrafët 20-28) dhe do të zbatojë atë model për të gjithë klasën e AAM-ve që vlerësohet”, nisur nga struktura e çdo prone, vlera e tyre efektive sipas çmimeve të tregut dhe masës së amortizimit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare zëri “Kafshë pune prodhimi” (llog. 217) për vlerën 55 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me nën llogaritë.

Nr.	Emërtimi	Njësia	sasia	çmimi	vlera
1	Lepuj	Copë	44	554	24,385
2	Kavie	Copë	30	200	6,000

3	Minj të bardhë	Copë	40	50	2,000
4	Desh	Copë	5	4,500	22,500
	Shuma				54,885

Kafshët e mësipërme shërbejnë për realizimin e qëllimeve eksperimentale dhe në funksion të kryerjes së testeve të ndryshme laboratorike, (grupi “Kavie”) dhe ISHP i njeh si aktive afatgjatë materiale (AQT) në përputhje me SKK 5. Edhe pse ato janë aktive biologjike, funksioni për të cilin ato mbarështohen nuk është në përputhje të plotë me SKK 13, sepse nuk janë të lidhura me veprimtarinë bujqësore. Pra, transformimi i tyre biologjik nuk menaxhohet nga njësi ekonomike për shitje (shiten në tregun e mishit) si prodhim bujqësor e blegtoral (qumështi dhe mishi i therur) ose aktive të tjera biologjike (pjellja e të vegjëlve).

Gjithashtu, për aktivet e mësipërme është llogaritur amortizimi i evidentuar në nënlllogarinë nr. 2197 “Kafshë pune e prodhimi” për vlerën 2 mijë lekë në vit për këtë grup të aktiveve, *më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

Nga sektori i financës të merren masat që, vlera e aktiveve biologjike, të cilat nuk janë të lidhura me veprimtarinë bujqësore dhe nuk janë të destinuara të krijojnë produkte bujqësore e blegtorale përmes transformimit biologjik, të kontabilizohet si AQT në llogarinë 2173 “Kafshë të tjera” për vlerën 54,885 lekë. Aduesit arsyetojnë se për këto aktive nuk duhet të llogaritet amortizim, pasi jeta e dobishme e një aktivi është “*periudha gjatë së cilës një aktiv pritet të jetë i disponueshëm për përdorim nga njësi ekonomike*” dhe se amortizimi i një aktivi fillon kur ai është i vlefshëm për përdorim, p.sh. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme që të jetë i aftë të operojë/punojë sipas mënyrës që synon menaxhimi, por sipas përdorimit të metodës së amortizimit ngarkesa e amortizimit mund të jetë zero kur nuk ka prodhim.

Në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017, në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar” për vlerën 6,779 mijë janë të pasqyruara sipas zërave “studime dhe kërkime”. Në analizë ky grup aktivesh përbëhet nga: “Arthro-kontroll; Vlerësimi i gjendjes dhe shkallës së riskut prej antropodeve” në vlerën 1,266,780 lekë, “Vlerësimi i gjendjes së jodit në popullatën shqiptare pas përmirësimit të profilaksisë së pa mjaftueshme jodike (2010 – 2015)” në vlerën 2,521,992 lekë, “Projekt preventiv qendra e trajnimeve ISHP” në vlerën 1,578,000 lekë, “Projekt preventiv zbatim rikonstruksioni i fasadës godina 4 kate ISHP viti 2011” në vlerën 455,000 lekë, “Projekt ide dhe projekt zbatimi për rikonstruksionin e laboratorit të kimisë analitike viti 2011” në vlerën 457,800 lekë dhe “Projekt preventiv zbatim rikonstruksion i disa ambienteve të brendshme të ISHP-së” në vlerën 472,800 lekë.

Nga auditimi u konstatuan:

4/a. Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë me shkresën nr. 2138, datë 19.4.2016, i është përcjellë ISHP, Urdhri i Ministrit me nr. 158, date 15.4.2016 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrim të Ministrisë së Shëndetësisë”, së bashku me metodologjinë e punës që do të ndiqet për evidentimin me saktësi të objekteve dhe territoreve në pronësinë dhe administrimin e institucionit, statusin e çdo prone, sipërfaqet totale dhe analitike të territorit dhe për çdo objekt. Në funksion të realizimit të përgjegjësi që burojnë nga ky urdhër, nga ana e ish-drejtorit të ISHP është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 1489 prot, date 31.10.2016 midis titullarit të AK dhe OE “L” SHPK, me vlerën 840 mijë lek me TVSH, likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 346, date 15.12.2016, sipas faturës tatimore nr. 34, datë 07.11.2016. Bashkëngjitur urdhër shpenzimit mungon fletëhyrja e këtij studimi dhe vlera prej 840 mijë lekë nuk është kontabilizuar si Aktiv i Qëndrueshëm i Patrupëzuar, por është njohur si shpenzim i ushtrimit.

Vlera prej **840 mijë** lek me TVSH, e studimit të kryer me objekt hartimin e dokumentacionit teknik për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore të Institutit të Shëndetit Publik nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017 si Aktiv i Qëndrueshëm i Patrupëzuar (AQPT).

Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

4/b. Nisur nga fakti që, një kategori e caktuar projektesh janë në funksionin konkret të një aktivi, siç është *“Projekt-ideja dhe projekt zbatimi për rikonstruksionin e laboratorit të kimisë”*, (për të cilën është realizuar dhe rikonstruksioni), vlera e projektit prej **457,800** lekë duhet të ishte tranzituar nga Aktivet e Qëndrueshme të Patrupëzuara tek grupimi Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuar, meqenëse me datën 14.09.2011 është kryer akti i marrjes në dorëzim të punimeve të realizuara nga *“D” Shpk*.

Si rrjedhojë, pas përfundimit të rikonstruksionit, vlera e projektit duhej kontabilizuar si pjesë e kostos historike të AQT dhe të amortizohej së bashku me vlerën e objektit, për të cilin është kryer ky projekt. Kjo në zbatim të kërkesave të Manualit të Klasifikimit Ekonomik, ku përcaktohet se:

“Duhet të kihet parasysh të dallohen projektet e blera ose të krijuara si të tilla (p.sh projekt për një standard rruge), të cilat konsiderohen si aktive të trupëzuara, nga projektet pjesë e kostos historike të aktiveve të trupëzuara të krijuara (p.sh: projekti për ndërtimin e një rruge të caktuar), të cilat konsiderohen si aktive të trupëzuara.”

4/c. Nga auditimi i studimeve dhe projekteve që klasifikohen si Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara (llog. 202) rezulton se, për projektin *“Vlerësimi i gjendjes së jodit në popullatën shqiptare pas përmirësimit të profilaksisë së pa mjaftueshme jodike (2010 – 2015)”*, janë përfshirë në vlerën e tij elementë, që sipas urdhër shpenzimeve të kaluara në degën e thesarit janë klasifikuar si shpenzime operative (llog. 602), për karburant dhe dieta, të cilat më pas me një artikull korigjues, janë përfshirë në vlerën e përgjithshme të aktivit.

Nga ana tjetër, për projektin *“Arthro-kontroll; Vlerësimi i gjendjes dhe shkallës së riskut prej antropodeve”*, rezulton se shpenzimet për karburant dhe dieta janë kontabilizuar si shpenzime ushtrimore dhe janë evidentuar në llogarinë 602. Për rrjedhojë, janë zbatuar dy standarde në regjistrimin e zërave që përfshihen në AQTP.

Sa më lart, është në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *“Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”*, Kapitullit II, *“Rregulla të përgjithshme për pasqyrat financiare vjetore”*, ku theksohet se *“aktivet përkufizohen si elemente të pasurisë së njësisë ekonomike me vlerë ekonomike pozitive. Ekziston një lidhje e ngushtë midis shpenzimeve që njësisia ekonomike kryen dhe hyrjes së një aktivi, por këto dy akte nuk përkojnë domosdoshmërisht, sepse: një element i blerë apo i krijuar është i lidhur gjithnjë me kryerjen e shpenzimeve, por këto të fundit mund të kapitalizohen dhe të përfshihen në bilanc vetëm nëse nga elementi i dhënë njësisia ekonomike ka siguri për përfitime ekonomike të ardhme. Në rast të kundërt shpenzimet e kryera konsiderohen shpenzime të ushtrimit dhe përfshihen drejtpërdrejt në rezultatin e tij”*;

4/d. Nga auditimi konstatohet se në llogarinë 202 *“Studime dhe kërkime”* janë përfshirë vlerat bruto të studimeve dhe projekteve, përkatësisht prej 6,778,988 lekë, (vlera e njëjtë për të dy vitet 2016 dhe 2017). Për këtë vlerë nga ana e Sektorit të Financës *nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara* që nga viti 2010, që shënon marrjen e këtyre shumave në llogarinë e aktiveve, referuar normave të amortizimit sipas VKM nr. 401, datë 23.10.1989 dhe Kreut III, pika 3.7.2 *“Normat e amortizimit sipas grupeve”*, të UMF nr.5, datë 30.01.2016 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* i ndryshuar, që përcakton se aktivet e trupëzuara amortizohen me normën vjetore të amortizimit prej 15 % në vit. Gjithashtu nuk është vepruar në pajtueshmëri me Seksionin I *“Aktivet e Qëndrueshme”*, të Standardeve dhe Rregullave Kontabël, miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, në bazë të së cilës, *“Amortizimi është konstatimi kontabël i pakësimit të vlerës së një elementi të aktiveve të qëndrueshme që rezulton nga përdorimi, nga koha, nga ndryshimet teknike dhe nga çdo shkak tjetër, efektet e të cilëve janë të pakthyeshme (përfundimtare). Për shkak të vështirësive të matjes së zhvlerësimit amortizimi konsiston, përgjithësisht, në shpërndarjen e vlerës së elementeve normalisht të amortizueshëm mbi të gjithë kohën e parashikuar të shërbimit të tyre”, si dhe Kapitullin III, Seksioni II, “Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara”, ku përcaktohet se: *“Ligji për “Për kontabilitetin“ parashikon një kufizim të afatit për amortizimin**

e këtyre aktiveve (deri në 5 vjet) nisur nga rreziqet që mund t'i vijnë kreditorëve të njësisë ekonomike në rast të një falimentimi, sepse disa elemente janë të pashitshme (p.sh. shpenzimet e nisjes e të zgjerimit), ose bëhen të pashitshme apo të pavlershme (p.sh. fondi tregtar). Megjithatë për elemente që gëzojnë një mbrojtje ligjore ose janë të lidhura me një element tjetër të trupëzuar amortizimi mund të bëhet në një afat më të gjatë”, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Nga ISHP, Sektori i Financës të merren masat për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve të Qëndrueshme të Pa Trupëzuara:

- Duke regjistruar dhe evidentuar si Aktive të Qëndrueshëm të Patrupëzuar (AQPT), vlerën prej 840 mijë lekë me TVSH, mbi studimin e kryer me objekt “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrim të Ministrisë së Shëndetësisë” pjesa e ISHP;
- Duke tranzituar nga llogaritë e AQPT vlerën e aktivitetit “Projekt-idesë dhe projekt zbatimit për rikonstruksionin e laboratorit të kimisë” prej 457,800 lekë për tek grupi i aktiveve AQT, meqenëse me datën 14.09.2011 është kryer akti i marrjes në dorëzim të punimeve të rikonstruksionit si rrjedhojë, pas përfundimit të punimeve, vlera e projektit duhet të kontabilizohet si pjesë e kostos historike të AQT (Laboratori i kimisë) si dhe të amortizohet së bashku me vlerën e objektit për të cilin është kryer ky projekt. Duke kryer përlllogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara që nga viti 2010, koha e marrjes së këtyre shumave në llogarinë e aktiveve.
- Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të ISHP-së, për vitin 2018.

Në vijimësi.

5. Gjetje nga auditimi: Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) në vlerën 1,560 mijë lekë për vitin 2016 dhe 41 mijë lekë për vitin 2017 ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre. Për këtë qëllim, u testua rregullariteti i operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet, që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

Rezulton se, për vlerën e furnitorëve nuk është dërguar letër konfirmimi për llogaritë e pagueshme, për të verifikuar nëse vlerat e tyre janë në përputhje me shënimet e kontabilitetit. Mosrakordimi me furnitorët mundëson edhe riskun e pagesave të parregullta, si dhe prezantimin jo të saktë e të plotë të detyrimeve në pasqyrat financiare.

- Gjithashtu për vitin 2017 u konstatua se, urdhër shpenzimi nr. 456, dt. 29.12.2017 për “Blerje materiale dhe kite për kërkim dhe diagnostikim për laboratorin e biologjisë molekulare dhe HIV, HEP, HPV, etj.” në vlerën 1,033,800 lekë i aprovuar dhe kaluar nga Dega e Thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2017 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis ISHP dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera. Vlera e mësipërme është likuiduar nga thesari në vitin 2018 dhe duhej të pasqyrohej në pasiv të bilancit në detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2017 në llogarinë 401 - 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” duke rritur vlerën nga 40,887 lekë në 1,074,687 lekë. Veprimi i mësipërm ka denaturuar detyrimet afatshkurtra duke mos paraqitur vlerën e vërtetë të furnitorëve dhe detyrimeve të prapambetura të vitit 2017 të cilat do të likuidoheshin në vitin 2018, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Drejtuesit e ISHP-së:

- Përpara miratimit të pasqyrave financiare, duhet të rishikojnë nëse janë marrë masat e nevojshme për njohjen reale të detyrimeve sipas kontratave të nënshkruara dhe faturave të regjistruara, kjo në bazë të standardeve të pranuar të kontabilitetit. Me qëllim të shmangies së gabimeve, duhet të bëhet harmonizimi i llogarisë së kontabilitetit me furnitorët, duke trajtuar saktësinë dhe plotësinë e këtyre llogarive.

- Të përcaktojnë rregullat që forcojnë kontrollin e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigorozë mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2016 në aktiv të bilancit në llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 12,930,760 lekë, të cilat si fonde të mbetura pa përdorur nga sponsorizimet sipas shpjegimeve të pasqyrave financiare, në pasivin e bilancit, janë paraqitur në llogaritë:

Llog. Nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” në vlerën 10,736,376 lekë.

Llog. Nr. 85 “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” në vlerën 2,194,384 lekë.

- Në pasqyrat financiare të vitit 2017, në llog. 520 “Disponibilitete në thesar” në aktiv të bilancit paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara për vlerën 12,930,761 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur nga sponsorizimet sipas shpjegimeve të pasqyrave financiare, në pasivin e bilancit, paraqitur në llogaritë:

Llog. Nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” në vlerën 9,870,649 lekë.

Llog. Nr. 85 “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” në vlerën 3,060,112 lekë.

Nga ISHP është mbajtur akti i rakordimit me degën e thesarit mbi të ardhurat për vitin 2017, ku janë cilësuar të ardhurat që mbeten për tu trashëguar në vlerën 3,060,112 lekë me emërtimin e llogarisë “Grante nga i njëjti nivel i qeverisjes (Projekte të Ministrisë së Mjedisit)” dhe jo sponsorizime siç cilësohet në formatin 3/2 dhe relacionet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Vlerat e mësipërme të kontabilizuara në llogaritë “Rezultati i mbartur nga funksionimi” dhe “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” denatrojnë këto llogari dhe vlera e mësipërme duhej të paraqitej në klasën 4 “Detyrimet afat shkurtra” që përfaqësohet nga shuma detyrimeve afatshkurtër (specifikisht të analizuar sipas llojeve dhe afateve, kryesisht në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” dhe “Llogari të tjera” që përfaqësohet nga shuma e posteve përkatëse të disa llogarive rregulluese që veprojnë në sensin kreditor). Në rastin konkret, si kundërparti duhet të shërbejë llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”, bazuar në përcaktimet e pikës 3, të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njërive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar. Llogaria 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, është llogari rregulluese që përfaqëson rezultatin e trashëguar nga viti ose vitet e mëparshme. Në të dhënat shpjeguese të llogarisë vjetore nuk shpjegohet besueshmëria ligjore e rezultatit të trashëguar dhe të sqarohet përbërja e tij (në ndarjen të konstatuara dhe të arkëtuara). Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë më vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepriçë kreditore e kësaj llogarie, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Nga ana ISHP të merren masat e mëposhtme:

- Sektori i Financës të marrë masat për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.
- Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni” në grupin e llogarive të klasës së 4, për një pasqyrim më të drejtë të kundërpartisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.
- Pasqyrat financiare vjetore, të përmbajnë një informacion më të plotë shpjegues, lidhur me pasqyrimin e fondeve, pasi konstatohet mungesa e informacionit mbi shpjegimet e nevojshme të mospërputhjeve të disa llogarive në aktet e rakordimit dhe bilancin kontabël.

- Sektori i Financës të informojë në vijimësi menaxhimin e lartë mbi nivelin e realizimit të sponsorizimit dhe fondeve duke i adresuar ato në llogaritë e duhura, si dhe të sqarojnë arsyet për mosrakordimin e të dhënave të pasqyruara në kontabilitet/bilanc me të dhënat e akteve të rakordimit, në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Mospërputhjet e të dhënave të bilancit dhe akteve të rakordimit:

a). Akti i rakordimit për shpenzimet:

- Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare 2016 për shpenzimet e ushtrimit, (formati nr. 3/1), nuk përputhen me vlerat e paraqitura më aktet e rakordimit të mbajtura me degën e thesarit Tiranë, pasi “*Shpenzimet korrente*” sipas bilancit paraqiten gjithsej për vlerën 491,577 mijë lekë, kurse sipas akt-rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 593,514 mijë lekë, shumë e cila nuk rakordon me shpenzimet korrente të pasqyrës nr. 3/1.

- Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare 2017 për shpenzimet e ushtrimit, (formati nr. 3/1), nuk përputhen me vlerat e paraqitura më aktet e rakordimit të mbajtura me degën e thesarit Tiranë, pasi “*Shpenzimet korrente*” sipas bilancit paraqiten gjithsej për vlerën 515,311 mijë lekë, kurse sipas akt-rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 528,742 mijë lekë, shumë e cila nuk rakordon me shpenzimet korrente të pasqyrës nr. 3/1.

Nga shqyrtimi i nënllogarive të paraqitura në aktin e rakordimit rezulton se p.sh në pasqyrat e bilancit 2016 gjendja e llogarisë nr. 605 “*Transferta me jashtë*” është zero, kurse vlera e shënuar në aktin e rakordimit është 332,295 mijë lekë. Po kështu, edhe në pasqyrat e bilancit 2017 gjendja e llogarisë nr. 605 “*Transferta me jashtë*” është zero, kurse vlera e shënuar në aktin e rakordimit është 239,992 mijë lekë.

Në pasqyrat financiare mungon shpjegimi dhe nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash financiare përfshihen në deklaratat financiare dhe shpjegimi përse nuk rakordojnë këto shuma.

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “*Procesimi i transaksioneve në fund të vitit*” dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Procedura standarde e zbatimit të buxhetit*”, Kreu III, “*Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike*”, nënkapitulli “*Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike*”, ku përcaktohet se:

Rakordimi mujor i shpenzimeve:

172. *Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.*

173. *Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Parë Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave.*

UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “*Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014*” pika 34 “*Degët e thesarit gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë në zbatim të manualeve përkatës*”, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Nga ana ISHP të merren masat e mëposhtme:

- Sektori i Financës të marrë masat për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.
- Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e ISHP-së dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast. Nga ana e Zv/Drejtorit Ekonomik dhe Nëpunësit Zbatues të përgatiten raporte periodike tremujore për menaxhimin e lartë, lidhur me

nivelin e shpenzimeve të realizuara kundrejt fondeve të akorduara, realizimin e regjistrit të prokurimeve të parashikuara sipas katër mujorëve, etj.

Periodikisht dhe çdo muaj

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të ushtrimit Formati 3/2 u konstatuan:

- Nga auditimi i “*Të ardhurat e ushtrimit 2016*”, sipas formatit nr. 3/2 të bilancit vjetor, kanë mospërputhje me të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik, të pasqyruara në aktin e rakordimit vjetor për të ardhurat. Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se, në bilancin kontabël (*Formati 3/2*), në llogarinë ekonomike 7207 “*Sponsorizime nga të tretët*” është vënë shuma 2,194,384 lekë, kur sipas aktit të rakordimit vlera e sponsorizonit nga të tretët është vetëm 322,424 lekë, kurse shuma prej 1,871,960 lekë është grant sipas një projekti, çelur nga Ministria e Mjedisit dhe duhet të paraqitet te vlera e granteve.

- Nga auditimi i “*Të ardhurat e ushtrimit 2017*” sipas formatit 3/2 të bilancit rezulton se vlera e llog. 7207 “*Sponsorizime nga të tretët*” në vlerën 3,060,112 lekë e paraqitur në formatin 3/2 përbëhet nga “*grante nga i njëjti nivel qeverisje (projekte të Ministrisë së Mjedisit*” në vlerën 2,737,688 lekë dhe sponsorizime në vlerën 322,424 lekë. Vlera e granteve nga i njëjti nivel qeverisës duhet të ndryshojë. Veprimi i regjistrimit të këtyre zërave grante si sponsorizime në pasqyrat e bilancit është e gabuar. Sa sipër, vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 3, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, ku shprehet se:

“Grant” është e ardhura, e përftuar në formën e dhurimit, për një qëllim të përcaktuar ose jo, pa kusht kthimi dhe pa interes, që përdoret për financimin e veprimtarive ekonomike” si dhe pikën nr. 1 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “*Për sponsorizimet*”, i ndryshuar me ligjin nr. 8282, datë 21.01.1998, ligjin nr. 9040, datë 27.03.2003 dhe ligjin nr. 9807, datë 20.09.2007, ku përcaktohet që: “*Ky ligj rregullon mbështetjen me ndihma financiare e materiale, të quajtura në vijim “sponsorizime”, të veprimtarive sociale e publike ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe botuesve të shtypit”* dhe nenit 3, sponsorizues në kuptim të këtij ligji “*janë vetëm subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, vendas, të huaj a me kapital të përbashkët. Subjektet buxhetore ose që përfitojnë financime buxhetore, nuk mund të jenë sponsorizues”*, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Nga ana ISHP të merren masat e mëposhtme:

- Sektori i financës të marrë masat për regjistrimin e drejtë dhe ndjekjen e nën llogarive të granteve dhe subvencioneve, duke respektuar klasifikimin ekonomik kontabël dhe bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “*Për sponsorizimet*”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar.
- Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për të ardhurat e ushtrimit nga veprimtaria e ISHP-së dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast. Nga ana e Zv/Drejtorit Ekonomik dhe Nëpunësit Zbatues të përgatiten raporte periodike tremujore për menaxhimin e lartë, lidhur me nivelin e të ardhurave të siguruara, arkëtimin e tarifave nga licencimi, kryerja e analizave, grantet etj., si dhe përdorimit të këtyre shumave.

Periodikisht dhe çdo muaj

9. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës sipas deklaratës doganore SAD ose datës sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si “*taksa e markimit*”.

Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “*Për rregullat e prokurimit publik*” kreu VIII, pika 2/b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 77, pika 3, “*Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e*

mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.....” pika 5 dhe 6, “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Nga ISHP në zbatimin e kontratave dhe likuidimin e vlerës së mallrave të furnizuara të merren masat si vijon:

- Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës dhe me deklaratën doganore SAD sipas kushteve të kontratës.
- Autoriteti kontraktor, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas deklaratës doganore SAD ose raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Me Urdhër Shpenzimin nr. 326, dt. 13.12.2016 janë likuiduar në favor të përfituesit “M” shpk sipas faturës tatimore nr. 1188, dt. 30.11.2016 vlera 582,988 lekë e pa firmosur nga përfaqësuesi i ISHP-së, sipas kontratës nr. 655/10, dt. 03.06.2016 për shërbimin me roje private. Bashkëngjitur këtij urdhër shpenzimi janë fatura tatimore e pa firmosur nga përfaqësuesi i ISHP-së, Situacioni për shërbimin për muajin nëntor 2016 i firmosur vetëm nga përfaqësuesi i “M” shpk, dhe listëprezenca e punonjësve të shërbimit për periudhën i firmosur vetëm nga drejtuesi teknik i “M” shpk.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 304, dt. 04.10.2017 janë likuiduar në favor të përfituesit “T” shpk sipas faturës tatimore nr. 139, dt. 30.09.2017 vlera 635,598 lekë e pa firmosur nga përfaqësuesi i ISHP-së, sipas kontratës nr. 844/1, dt. 11.07.2017 për shërbimin me roje private. Bashkëngjitur këtij urdhër shpenzimi janë Fatura tatimore e pa firmosur nga përfaqësuesi i ISHP-së, Situacioni për shërbimin për muajin shtator 2017 i firmosur vetëm nga përfaqësuesi i “T” shpk, dhe listëprezenca e punonjësve të shërbimit për periudhën shtator 2017 i firmosur vetëm nga drejtuesi teknik i “T” shpk.

Bashkëngjitur urdhër shpenzimit mungojnë dokumentet e marrjes në dorëzim të shërbimit me roje private si procesverbalet ose një dokument ku një komision ose përfaqësues i ISHP të jetë shprehur për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet e kontratës.

Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj*

Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 3, “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.....”. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 54 “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore.... financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës”, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Nga ISHP të merren masat që:

Marrja në dorëzim e shërbimeve sipas kontratave të lidhura, (duke përfshirë këtu dhe shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike në mjediset e Institutit), të konfirmohet dhe dokumentohet rregullisht nga një komision i ngritur nga Drejtori i ISHP, që duhet të ngrihet dhe funksionojë në përputhje me përcaktimet e dispozitave dhe kuadrit nënligjor mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetin publik.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Regjistrimi i pasurisë: Ndonëse nga ana e Institutit të Shëndetit Publik është zbatuar detyrimi i pikës nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, meqenëse është përgatitur inventari i pronave shtetërore nën përgjegjësinë e tyre administrative, si dhe i janë përcjellë Ministrisë së linjës, ende nga ISHP nuk janë dërguar në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP) listat e inventarit, për t’iu dërguar më tej për miratim Këshillit të Ministrave. Nuk ka asnjë praktikë shkresore apo kërkesë administrative, ku ti kërkohet AITPP në Ministrinë e Brendshme, regjistrimi i inventarizimit të pronave të institucionit. Gjithashtu, vërehet se mungon aprovimi i listës së pronave dhe fillimi i procedurave për miratimin e listës së inventarit. Gjithashtu konstatohet se, nuk është finalizuar procesi i miratimit të listës së pronave dhe nuk është vijuar me procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP.

Sa më sipër, në kushtet që nga ana e ISHP nuk janë regjistruar pronësitë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

- Drejtori i ISHP, të ngrëjë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e këtyre objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për vlerësimin e trojeve dhe të pronave që ky Institut ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit.
- Të riaplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve të ISHP.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve (llog. 214 Ins. Teknike makineri pajisje 414,088,967 lekë dhe llog. 218 Inventar ekonomik 133,535,349 lekë) për vitin 2016 është hartuar një informacion për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e ISHP-së, për vitin 2016. Gjithashtu nga komisioni i inventarizimit të aktiveve (llog. 214 “Ins. Teknike makineri pajisje” 419,545,605 lekë dhe llog. 218 “Inventar ekonomik” 143,513,238 lekë) për vitin 2017 është hartuar një informacion për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e ISHP-së, për vitin 2017.

Nga auditimi u konstatuan se:

- Në një informacionin e inventarizimit 2017 nuk janë pasqyruar diferencat e konstatuara për “Ins. Teknike makineri pajisje” në vlerën **1,854,601** lekë.
- Nga ISHP për vitin 2016 dhe 2017 nuk janë inventarizuar e kontrolluar për ekzistencën dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktivet afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës, në kundërshtim me nenin 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Inventarizimi i aktiveve. Pika 74, që nënvizon se, “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë te paktën një here në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve

afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

- Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, mirëpo nga ana e kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit sipas UMF nr. 30, datë 27/12/2011 për të vijuar procedurat dhe praktikat me: “procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; hartimin e proces verbalit të vlerësimit; evidentimin e listës së aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme”.

- Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, në kundërshtim me paragrafin nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. Nuk ka një evidentim të situatës së inventarizimit për çdo llogari, krahasim të gjendjeve kontabël dhe fizike për gjithë asetet (aktivet materiale dhe jomateriale), arsyetimi i shkaqeve mbi diferencat, inventari jashtë funksioni, arsytet për këtë, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj.

- Nga komisionet e ngarkuara me inventarizimin e aktiveve për vitin 2016 dhe 2017 nuk janë hartuar raporte për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, (ekziston vetëm informacioni mbi inventarin në përdorim të punonjësve në zyrat dhe ambientet e ISHP), në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, që sanksionon detyrimin e komisionit, “të përpilojë një raport lidhur me: inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues”.

- Procesi i inventarizimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, siç përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr. 30/2011, që përcakton se “ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim i bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale”, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

- Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuar dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Drejtuesi i ISHP të analizojë diferencat e inventarit të konstatuara për “Ins. Teknike makineri pajisje” në vlerën **1,854,601** lekë, si dhe të kryhen regjistrimet e nevojshme në kontabilitet pas adresimit të përgjegjësive përkatëse.
- Nga strukturat e menaxhimit të ISHP të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.
- Drejtori i ISHP duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionet për vlerësim të pasurive në mënyrë që të sigurojë informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë. Gjithashtu, Nëpunësi Zbatues detyrimisht para se të kryhet inventarizimi fizik i aktiveve nga komisionet përkatëse, është i detyruar që tu vejë në dispozicion regjistrat e aktiveve sipas gjendjeve kontabël, ku komisionet kanë për detyrë për të evidentuar sasitë fizike.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formati 12 “*Pyetësor dhe shënime shpjeguese*” është plotësuar relacioni shpjegues për pasqyrat financiare por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë, *më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me pyetësorët dhe relacionin shpjegues për pasqyrat financiare ku të përfshihen të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi:

14.1. Nga auditimi mbi menaxhimin financiar në Institutin e Shëndetit Publik, ka rezultuar se organizimi dhe veprimtaria administrative, mbështeten në një rregullore të brendshme të vitit 2013, e cila nuk është miratuar nga ministria e linjës. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”, ku shprehet se: “*Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij*”. Disa vite pas hartimit të rregullores së brendshme të ISHP-së, me shkresën nr. 871, datë 23.06.2017, është kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratimi i rregullores së brendshme të institucionit. Deri në datën e mbajtjes së këtij raporti nuk rezulton se ky dokument të jetë miratuar nga Ministri i Shëndetësisë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me nenin 29 pika 2 të ligjit nr. 90/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”, ku thuhet se, “*Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.*”

Sa më sipër, Instituti i Shëndetit Publik për periudhën e audituar nuk ka një rregullore të miratuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

14.2. Nga auditimi u konstatua se, në përcaktimin e nëpunësit zbatues nuk ka gjetur zbatim neni 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*”, ku cilësohet se, “*Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë. Nga auditimi konstatohet se, nëpunësi zbatues nuk është në varësi direkte nga nëpunësi autorizues pasi në strukturën e miratuar përgjegjësi i sektorit të financës përgjigjet përpara drejtorit të shërbimeve mbështetëse, i cili nga ana e tij përgjigjet dhe raporton përpara dy zv. drejtorëve teknike dhe ekonomikë dhe para drejtorit të ISHP.* Referuar strukturës organike dhe organigramës së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me shkresën nr.220/1, datë 17.02.2014 “*Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Institutit të Shëndetit Publik*”, nëpunësi zbatues nuk është në varësi direkt nga nëpunësi autorizues, (Drejtori i ISHP), por është në varësi nga Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe dy Zv. Drejtorët, *më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

Drejtori i ISHP të rishikojë strukturën e institucionit si dhe të azhurnoje rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, e hartuar në vitin 2014, duke e plotësuar dhe harmonizuar me kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe ta përcjellë për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Brenda 3 muajve

15. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Drejtorit të ISHP, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e një Komiteti që duhet të evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, duk vepruar në kundërshtim me përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku përcaktohet se:

Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të veprojë si një komitet, ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut. Ai duhet të këshillojë Nëpunësin Autorizues mbi përmbajtjen e raportit vjetor për efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut.

Si dhe kreun II, pika 2.2.6 të Manualit të ri të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, ku nënvizohet se:

“GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike”.

Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për hartimin e strategjisë për hartimin e regjistrit të riskut për vitin 2016 si dhe strategjisë për periudhën objekt auditimi, duke vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21, të ligjit nr.10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Për vitin 2016 nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve dhe adresimi i personat përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Kryeministri dhe në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të Kreut III “Identifikimi i risqeve” të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

- Drejtori i ISHP të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik, me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Nëpunësi autorizues të marrë masa dhe ngrejë grupin e punës për rishikimin dhe përditësimin e regjistrit të risqeve dhe hartimit të strategjisë për menaxhimin e risqeve financiare dhe operacionale që kërcënojnë arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga nenet 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21, të ligjit nr.10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: ISHP nuk ka arritur të shfrytëzojë të gjitha mjetet nga grantet dhe subvencionit, përkatësisht për 10,736 mijë lekë dhe 2,194 mijë lekë, (kryesisht të krijuara që nga viti 2002), shumë kjo e barabartë me rreth 44 % të të ardhurave gjithsej të siguruara për vitin 2016 prej 29,434 mijë lekë dhe përkatësisht për 9,871 mijë dhe 3,060 mijë lekë, shumë kjo e barabartë me rreth 45 % të të ardhurave gjithsej të siguruara për vitin 2017 prej 28,631 mijë lekë

Në këtë kohë në bazë të raporteve të dërguara për ministrinë dhe institucionet e tjera, ka lindur nevoja e rikonsiderimit dhe përdorimit të këtyre shumave. Konstatohet se nuk është arritur të realizohen të gjitha objektivat lidhur me përdorimin e disa fondeve, me dispozicion për qëllime të caktuara, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandojmë:

Strukturat përgjegjëse të ISHP të sigurojnë menaxhim më efikas të mjeteve nga subvencionet dhe donacionet, për të siguruar shërbim të qëndrueshëm për popullatën e vendit në kushtet e risqeve të shtura të përhapjes së sëmundjeve të ndryshme infektive.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Për 13 automjetet në funksion të ISHP, në çdo rast tërheqja e sasisë së karburantit është kryer mbi bazën e dokumentacionit autorizues. Megjithatë, *janë vërejtur mangësi e parregullsi, pasi në disa raste të dhënat mbi kilometrat apo sasi të karburantit të regjistruara në fletët e udhëtimit janë me korrigjime, në disa raste janë konsideruar lëvizje të brendshme pa specifikuar destinacionin dhe duke mos pasqyruar saktë masën e konsumit të karburantit të automjeteve, është shënuar vetëm destinacioni i nisjes ose kthimit, regjistruar destinacione që nuk janë të lexueshme, janë të pakuptueshme, etj., në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07. 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe paragrafin nr. 36, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, ku përcaktohet se: “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”: si dhe pikën nr. 6, Kreu II, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Nga ISHP janë hartuar normativat e harxhimit për sasi të karburantit që konsumohet për një orë pune për gjeneratorin dhe për secilën nga mjetet por këto normativa nuk janë të miratuara nga titullari, më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 11-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

- Sipas kompetencës, nga ISHP të miratohen normativat e harxhimit të karburantit për automjetet si dhe të përmirësohen praktikat dhe kontrollet e brendshme për regjistrimin dhe dokumentimin e drejtë të konsumit të karburantit nga automjetet.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të ISHP: Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” deri në “Largim nga puna” për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R